



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 02/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.01.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-41722-10-31-2019, me objekt: “Blerje program kompjuterik dhe kurse”, me fond limit 2.083.333 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 21.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

Ankimues: “Kreatx” shpk
Rr.”Sami Frashëri”, nr.39, kati II, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor Bashkia Himarë
Spile, Himarë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes.

II.1. Në datën 01.11.2019 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-41722-10-31-2019, me objekt: “Blerje program kompjuterik dhe kurse”, me fond limit 2.083.333 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 21.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

II.2. Në datën 07.11.2019, operatori ekonomik “Kreatx” sh.pk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, duke kundërshtuar kërkesat e dokumentave të tenderit, si më poshtë vijon:

“Ne date 01.11.2019 eshte shpallur nga Autoriteti Kontraktor "Bashkia Himare", procedura "Kerkese per Propozim", me objekt: Blerje Program Kompjuterik dhe Kurse, dhe me fond Limit: 2,083,333 (dy milion e tetedhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lek) Lek pa TVSH.

Nga shqyrtimi i DST dhe i kerkesave te paraqitura ne DST, kemi konstatuar se disa prej kriterëve ishin ne kundërshtim me parimin ligjor te mosdiskriminimit. Referuar Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurirnin Publik", i ndryshuar , Neni 2 parimet e perzgjedhjes percaktohet se te gjithe operatoret ekonomik duhet te jene ne kushte mosdiskriminimi dhe kandidatet duhet te trajtohen ne menyre te

barabarte dhe Nenit 20 te LPP " Mosdiskriminimi", subjekti ankues, nuk eshte dakord me disa pika te kriterëve te vecanta te kualifikimit, si me poshte:

Pika 6 e kriterëve te vecanta te kualifikimit

6. Operatori Ekonomik të jetë min Gold Partner referuar bazës së të dhënave me qëllim suportin e RDBMS dhe sigurimin e të dhënave dhe respektimin e starndarteve kombetare te nderveprimit.”.

Kerkesa juaj per kualifikim ne nivelin Gold nga prodhuesi, eshte nje kriter i cili bie ndesh me parimet e LPP te cilat jane transparence, barazi dhe mosdiskriminim. Niveli i Partneritetit Gold eshte nje certifikate qe lidhet kryesisht me xhiron vjetore qe operatori ekonomik kryen prane nje prodhuesi te caktuar brenda 12 muajve. Gjithashtu niveli i partneritetit Gold kerkon pagese vjetore ndaj nje prodhuesi te zgjidhjeve RDBMS ne kembim te ruajtjes se nivelit te partneritetit. Nuk mund te diskriminohet nje shoqeri e cila nuk ka bere blerje, deri ne nje vlere te caktuat pergjate nje viti financiar. Ky eshte nje kriter qe haptazi favorizon operator ekonomik te caktuar, ul ne menyre te ndjeshme konkurrencen dhe eshte ne shkelje flgrante te LPPP. Ligji per fuqine teknike dhe ekonomike te opertorit, ka cktuar kriterin e xhiros se tre viteve te fundit. Formulimi i bere nga LPP, garanton dhe propocionalitetin e kerkesave teknike me objektin e prokurimit. Kerkojme heqjen e kriterit per kualifikimin ne nivelin Gold nga prodhuesi RDBMS.

Pika 7 e kriterëve te vecanta te kualifikimit

7.Operatori ekonomik duhet te jete i autorizuar nga autori i programit kompjuterik per integrimin me sistemin e UK Himare.

Ky kriter parapercakton fituesin, per shkak se askush tjeter pervec prodhuesit te sistemit te UK Himare, ose nje kompanie qe ka rene dakord paraprakisht me te, nuk mund te disponoje kete lloj autorizimi. Autoriteti Kontraktor nuk ka dhene asnje informacion se cila eshte kompania qe ka ndertuar sistemin e UK Himare. Nese do te jepte kete informacion, do te kishte shkruar ne DST edhe emrin e kompanise fituese te kesaj procedure. Ne vleresojme se nepermjet ketij kriteri eshte duke diskriminuar dukshem, te gjithë operatorët ekonomike qe mund te zhvillojne me se miri sistemin informatik te kerkuar prej kesaj procedure, duke disponuar burime njerezore dhe te gjithë kapacitetet ekonomike dhe teknike te kerkuara. Ne stadin e sotem teknologjik cdo sistem qe ka karakteristikat e kerkuara ne dokumentin teknik (specifikimet teknike) te procedures, me objekt “Blerje program kompjuterik dhe kurse”, mund te integrohet thjeshtesisht me Sistemin Informatik te Faturimit te UK Himare, sipas protokolleve standarde.

Pika 9 e kriterëve te vecanta te kualifikimit

9. Operatori ekonomik duhet të deklarojë të gjithë stafin dhe personelin e tij tekniko-profesional, i cili do të angazhohet në këtë projekt. Në përbërje të stafit duhet të ketë specialistë të certifikuar në komponentet e mëposhtem:

a) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi një punonjës Menaxher projektesh të certifikuar në fushën e menaxhimit të projekteve (Project Management Accreditation ose ekuivalent”.

Ky kriter domosdoshmerisht, paracakton fituesin, per shkak se askush tjeter pervec nje kompanie nuk disponon kete lloj certifikate. Si pale e interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi, ne kerkuam ne internet se cili eshte autoriteti/kompania qe leshon kete lloj certifikate. Ng kerkimi yne rezultoi se kompania e cila leshon kete certifikate, eshte kompania "Smart Processs" shpk me objekt "Prodhime dhe shitje te programeve kompjuterike". Konsulence menaxheriale". Kjo shoqeri nuk ka ne objektin e saj trajnime dhe certifikime per pale te treta dhe ne QKB nuk ka sanje licence aktive per formim profesional. Pra eshte e pamundur per nje shoqeri tjeter konkurrenente ose per nje individ te pajiset me certifikimin :Smart Processses Certifies Professional".

Ne vleresojme se nepermjet ketij kriteri, Autoriteti kontraktor eshte duke diskriminuar dukshem te gjithë operatorët ekonomike qe mund te zhvillojne me se miri sistemin informatik te kerkuar prej kesaj procedure, duke disponuar burime njerezore dhe certifikata te ngjashme me ate te kerkuar ne kete kriter. Ne stadin e sotem teknologjik, cdo sistem qe ka karakteristikat e kerkuara ne DST dhe ne specifikimet teknike te procedures me objekt "Dixhitalizimi i sherbimit per abonente" mund te integrohet thjeshtesisht me sistemin informatik te kerkasave/ankesave te abonenteve prane sporeteleve fizike te institucionit qe autoriteti kontraktor ka ne perdorim. Mungesa e marrjes parasysh te certifikatave ekuivalente eshte ne kundërshtim te plote me ligjin dhe shkakaton dukshem diskriminim te te gjithë operatorëve ekonomike qe zoterojne kapacitet per ta kryer kete sherbim te kerkuar ne procedure, por qe kane te punesuar specialist me certifikata ekuivalente me ate qe kerkohet. Gjithashtu Autoriteti Kontraktor eshte duke shkaktuar nje dem ekonomik pasi pengimi ne menyre arbitrare eshte ne kundërshtim me ligjin e se drejtes per te garuar lirisht dhe diskriminimi i konkurrences se ndershme, pa dyshim qe eshte premise per keqpedorimin e burimeve financiare prej AK-se.

Sa me siper kerkojme:

1. Pranimin e ankimit
2. Te kryhet ndryshimi ne DST ne kriterin e vecante te kualifikimit duke hequr nga kriteret e kualifikimit:

Piken 6- Operatori ekonomik duhet te jete min Gold Partner referuar bazes se te dhenave me qellim suportin e RDBMS dhe sigurimin e te dhenave dhe respektimin e standarteve kombetare te nderveprimi.

Piken 7 -Operatori ekonomik duhet te jete i autorizuar nga autori i programit kompjuterik per integrimin me sistemin e UK Himare.

Pika 9 germa c) te modifikohet duke perfshire dhe njohur te vlefshme edhe certifikime te ngjashme nga autoritete te licensuara".

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. prot. 3090/1, datë 14.11.2019 autoritetit kontraktor i kthen përgjigje operatorit ekonomik "Kreatx" shpk, ku ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës, si më poshtë:

" Ne lidhje me piken 6 ku kemi kerkuar se operatori ekonomik duhet te jete min Gold Partner referuar hazes se te dhenave me qellim suportin e RDBMS dhe sigurimin e te dhenave dhe respektimin e standarteve kombetare te nderveprimi.

Komisioni i shqyrtimit te ankesave arriti ne perfundimin te hiqet pjesa ku kerkohet qe operatori ekonomik duhet te jete "Minimumi Gold Partner" dhe shtohet kriteri si me poshte :

"Operatori ekonomik •duhet te plotesoje suportin e RDBMS dhe sigurimin e te dhenave dhe respektimin e standarteve kombetare te nderveprimit te percaktuara nga AKSH-i

Ne lidhje me piken 7, ku kerkohet qe operatori ekonomik te jete i autorizuar nga UK Himare qe te nderveproje me te dhenat e veta, te shtojte, modifikoje ose fshij.

Ne lidhje me piken 9 germa "c", ku eshte kerkuar qe "Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar minimumi nje punonjes te certifikuar per "Smart Processes Certified Professional", per implementimin e proceseve te integritimit dhe llogaritjeve te taksave. Per te vertetuar kete kriter operatori ekonomik duhet te paraqese certifikaten perkatese, kontraten e punes, cv, diplomen"; Komisioni i shqyrtimit te ankesave ka marre ne konsiderate ankesen tuaj ne lidhje me kete pike dhe vendosi qe ta heq".

II.4. Në datën 19.11.2019, operatori ekonomik "Kreatx" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke ngritur vetëm pretendimin për heqjen e pikës 7 që ndodhet në Kriteret e vecanta të kualifikimit, në pikën 2.1 "Për kapacitetin ligjor".

"Ne date 01.11.2019 eshte shpallur nga Autoriteti Kontraktor "Bashkia Himare", procedura "Kerkese per Propozim ", me objekt: Blerje Program Kompjuterik dhe Kurse, dhe me fond Limit: 2,083,333 (dy milion e tetedhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre lek) Lek pa TVSH.

Nga shqyrtimi i DST dhe i kerkesave te paraqitura ne DST, kemi konstatuar se disa prej kriterëve ishin ne kundërshtim me parimin ligjor te mosdiskriminimit. Referuar Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar , Neni 2 "Parimet e perzgjedhjes ", percaktohet se te gjithë operatorët ekonomike duhet te jene ne kushte mosdiskriminimi dhe kandidatet duhet te trajtohen ne menyre te barabarte, Nenit 20 te LPP dhe nenit 23 te LPP.

Duke mos qene dakord me disa pika te kriterëve te vecanta te kualifikimit, subjekti ankues, ne date 04.11.2019, iu drejtua Autoritetit Kontraktor per ti kontestuar ato, ku me pergjigjen e dates 14.11.2019, ky i fundit do te pranonte pjeserisht ankimin e paraqitur nga ana jone, duke pranuar konkretisht te hiqte apo ndryshonte piken 6 dhe piken 9, germa "c", te dokumentit KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT.

Ne lidhje me piken 7, ne dokumentin KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT, ku konkretisht Autoriteti Kontraktor percaktonte se:

"7. Operatori ekonomik duhet te jete i autorizuar nga autori i programit kompjuterik per integrimin me sistemin e UK Himar "; nga pergjigja e sipercituar, e dates 14.11.2019, te ketij te fundit (edhe pse ne vleresimin tone eshte nje pergjigje ne thelb e paqarte dhe jo e ndertuar ne menyre korrekte nga pikpamja gjuhesore), konstatojme se kjo pike nga Autoriteti Kontraktor eshte modifikuar ne kete menyre:

"7. Operatori ekonomik te jete i autorizuar nga UK Himare qe te nderveproje me te dhenat e veta, te shtojte, modifikoje ose fshij".

Ne vleresimin tone, ky ndryshim i kriterëve te vecanta te kualifikimit, keshtu si eshte kryer modifikimi, eshte totalisht i pa vlere per sherbimin qe po ofrohet dhe per arsyet qe po kerkohet. Ne vleresimin tone,

kualifikimi i nje oferte apo jo, nuk mund te varet nga autorizimi i nje enti tjeter (konkretisht Ujesjellesi Himare), i cili mund ta leshoje ose jo kete autorizim. Ne dijenine tone nuk ka asnje lloj procedure te standartizuar si mund te kerkohet ky autorizim dhe cilat jane kriteret qe duhet te permbushe kompania jone. Ne modifikimin e ketij kriteri AK nuk ka dhene asnje sqarim cila eshte procedura e marrjes se ketij autorizimi ose vertetimi. Per marrjen e ketij autorizimi UK Himare nuk ka asnje afat per sa kohe duhet te ktheje pergjigje dhe kjo mund te coje ne mospermbushjen e ketij kriteri nga subjektet e interesuara. I vetmi subjekt i cili ka avantazh dhe perfitim direkt nga vendosja e ketij kriteri eshte subjekti i cili ka ndertuar sistemin informatik te UK Himare, i cili ka marredhenie te drejteperdrejte me kete Ujesjelles.

Gjejme me vend te bejme nje sqarim te domosdoshem ne lidhje me kete kerkim absurd dhe me situaten e ketij objekti prokurimi. Ujesjelles Kanalizime Himare eshte nje shoqeri aksionare, me fonde publike, dhe me aksioner te vetem Bashkine Himare, pra Autoritetin Kontraktor. Te drejten per te ndervepruar me bazen e te dhenave te UK Himare sh.a., ne vleresimin tone, nuk mund ta kete dhe nuk mund ta marre nje subjekt ofertues, por kete te drejte apo autorizim duhet ta kete perpara se te shpallej ky prokurim, autoriteti kontraktor, i cili eshte dhe subjekti pergjegjes per mbrojtjen apo trajtimin e ketyre te dhenave. Te detyrosh, subjektet private, 5 dite para dates se dorezimit te ofertave, qe te pajisen me nje autorizim per te kryer kete nderveprim, ne kendveshtrimin tone eshte nje veprim abuziv.

Ky subjekt, pra Ujesjelles Kanalizime Himare sh.a., i cili eshte i kontrolluar nga Autoriteti Kontraktor, nepermjet administratorit te vet mund te diskriminoje njerin apo tjetrin subjekt, ne mungese te nje kriteri objektiv apo akti normativ. Natyrshem ne kete situate na lind pyetja, kur ky subjekt kontrollohet totalisht nga autoriteti kontraktor, dhe nderveprimi i te dhenave do te kryhet per llogari po te ketij subjekti, per cilen arsye iu kerkohet subjekteve private autorizime apo dokumentacione te kota. Ky kriter, ndryshuar si me siper, domosdoshmerisht parapercakton ndonje fitues te mundshem, ose subjekti fitues i mundshem, si parashtroam me siper, do varej totalisht nga deshira apo diskrecionaliteti i nje enti publik, qe funksion me te ardhurat e publikut.

Ne vleresojme se nepermjet ketij kriteri, Autoriteti Kontraktor, eshte duke diskriminuar dukshem te gjithë operatorët ekonomik qe mund te zhvillojne me se miri sistemin informatik te kerkuar prej kesaj procedure, duke disponuar burime njerezore dhe te gjithë kapacitet ekonomike dhe teknike te kerkuara, por qe nje burokraci te kote, duhet te marrin nje autorizim nga nje entitet tjeter publik brenda nje afati kohor shume te shkurter. Vleresojme te sqarojme se ne stadin e sotem teknologjik cdo sistem qe ka karakteristikat e kerkuara ne dokumentin teknik (specifikimet teknike) te procedures me objekt "Blerje Program Kompjuterik dhe Kurse" mund te integrohet thjeshtesisht me Sistemin Informatik te Faturimit te UK Himare sipas protokolleve standarde.

Vendosja e nje kriteri te tille diskriminues duke lidhur nje procedure prokurimi (e cila zhvillohet nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Himare) me nje Autoritet tjeter te kontrolluar po nga AK, ne vleresimin tone, eshte ne kundërshtim te plote me ligjin dhe shkakton dukshem diskriminim te te gjithë operatorëve ekonomike qe zoterojne kapacitet per ta kryer kete sherbim te kerkuar ne kete procedure.

Autoriteti Kontraktor është duke na shkaktuar një dëm ekonomik pasi pengimi në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim me ligjin i së drejtës për të garantuar lirisht dhe diskriminimi i konkurrencës së ndershme, pa dyshim që është premise për keqpërdorimin e burimeve financiare prej Autoritetit Kontraktor. Në rastin konkret, kriteri i kërkuar nga ana e AK, është një kërkesë me emer të vecante, dhe konkretisht UK Himare sh.a., e kontrolluar nga Bashkia Himare, pra rrjedhimisht një subjekti totalisht i njëanshem”, që bie ndesh me përcaktimet e nenit 23 "Specifikimet teknike".

II.5. Në datën 13.12.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1774/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 3090/2 prot, datë 11.12.2019, bashkëngjitur informacioni dhe dokumentacioni mbi hartimin e dokumentave të tenderit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se *“Kërkojme që të hiqet nga DST pika 7 që ndodhet në Kriteret e vecanta të kualifikimit, në piken 2.1 “Kapaciteti ligjor”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, seksioni 2.1 “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë”, pika 7 e dokumentave të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ishte:

“7.Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autori i programit kompjuterik për integrimin në sistemin e UK Himare”.

Bëhet

“7. Operatori ekonomik të jetë i autorizuar nga UK Himarë që të ndërveprojë me të dhënat e veta, të shtojë, modifikojë ose fshij”.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit

me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës duke evituar konfuzionin sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e konfuzionit dhe paqartësisë tek operatorëve ekonomikë në përgatitje e ofertës. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “2. Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

III.1.3. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor tek shtojca përkatëse mbi “Specifikimet teknike”, nuk ka vendosur asnjë të dhënë konkrete në lidhje me programet kompjuterike/kurset që do të prokurohen, e për rrjedhojë gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor se “Operatori ekonomik të jetë i autorizuar nga UK Himarë që të ndërveprojë me të dhënat e veta, të shtojë, modifikojë ose fshij”, është një kërkesë jopropocionale, duke patur parasysh objektin e kontratës “Blerje program kompjuterik dhe kurse”; pasi e tejkalon volumin dhe përmasat e kontratës që prokurohet, e për këtë arsye KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kriterit në fjalë.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-41722-10-31-2019, me objekt: “Blerje program kompjuterik dhe kurse”, me fond limit 2.083.333 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 21.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Himarë.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx”.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1774 Protokolli, Datë 19.11.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha